



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.273/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Anr.273/2025 e datës 31.01.2025,
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2, 000.00 ( dymijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 31.01.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës ku pretendohet se më datë 29 janar 2025, në ora 21:57, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje znj. Liza Gashi ka publikuar një fotografi në rrjetin social facebook ku në një rën nga sekuenat e kësaj video vërehen disa fëmije të mitur, nën moshën 15 vjeçare, të cilët përdorën nga e njëjta me qëllim të organizimit të fushatës zgjedhore dhe përfutimit të votave. Parashtruesi i ankesës ka vlerësuar se në veprimet e znj. Liza Gashi janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Video e publikuar në rrjetin social Facebook, nga kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, znj.Liza Gashi ku vërehen disa fëmijë të mitur, nën moshën 15 vjeç.

<https://www.facebook.com/liza.n.gashi/videos/116270411252604711/>.

Provë: Screenshot i postimit të Postimi nga znj.Liza Gashi e cila është publikuar më 29 janar 2025, në ora 21:57/h.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje e kundërshton ankesën me arsyetimin se ankesa e tillë është e pabazuar dhe e paqëndrueshme. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar pamjet e tilla janë digjitale, të autorizuara dhe të licencuara nga platforma Envato Elements dhe nuk është përdorur asnjë fëmijë real në fushatë. Si dhe përmes përgjigjes në ankesë ka propozuar që ankesa e palës parashtruese, të refuzohet si e pa bazuar.

Si provë ka bashkangjitur linkun e platformës: <https://elements.envato.com/>.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli ka gjetur se nga video e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik LVV, përkatësisht kandidatja për deputete nga radhët e LVV znj. Liza Gashi në postimin e saj në rrjetin social facebook ka publikuar një video në të cilën janë përfshirë edhe fëmijë, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se *"Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore"*. *Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.*

Paneli ka hyr në linkun e prezantuar nga subjekti politik LVV, mirëpo nga ajo që është paraqitur nga ky link nuk është vërtetuar pretendimi se pamjet e tilla janë digjitale, të autorizuara dhe të licencuara nga platforma Envato Element dhe se nuk është përdorë asnjë fëmijë real. Subjekti politik në fjalë është dashur që për një pretendim të tillë të siguroj prova konkrete që argumentojnë se pamjet e tilla janë marr nga platforma e pretenduar dhe se fëmijët e përdorur nuk janë real.

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik LVV, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga video e ofruar si dëshmi nga subjekti politik PDK shihet se në postimin e kandidatës për deputete nga radhët e LVV znj. Liza Gashi, në rrjetin social facebook shihet qartë përdorimi i fëmijës nën moshën 15 vjeç, gjatë fushatës zgjedhore për përfitime të votave për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga

parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara më lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.273/2025 datë 03.02.2025

Kryesuese e Panelit  
Violeta Husaj Rugova



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***